



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

25-09-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Numri i lëndës: 2018:010981

Datë: 11.06.2018

Numri i dokumentit: 00059276

Më
Dana _____ 2018

P.nr.2917/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin Ilir Bytyqi, me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.963-2/16 te dt. 16.11.2017, pas mbajtjes së seancë së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], si dhe të akuzuarit [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] [REDACTED] me dt. 28 Maj 2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 31 Maj 2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

Te akuzuarin: [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me vendbanim në Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, i gjendjes së dobët ekonomike, ka te kryer shkollën e mesme të elektros, i martuar, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 30.06.2016, rreth orës 09:30, në rrugën “Enver Topalli” në Ferizaj, përkatësisht tekë kryqëzimi i kësaj rruge me rrugën “12 Qershori”, duke drejtuar automjetin transportues të markës Man, targa të regjistrimit [REDAKTUAR] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, gjatë kyçjes nga rruga “Enver Topalli” në rrugën “12 Qershori”, e godet me pjesën e përparme këmbësorin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K. Ferizaj, i cili ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor, e i cili nga kjo goditje merr lëndime vdekjeprurëse dhe ndërton jetë në vendin e ngjarjes.

**me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9
lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.**

Andaj, në bazë nenit 378 dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës,
dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin [REDAKTUAR] e

G J Y K O N

- **ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1 /një/ Vit, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim te ekzekutimit me dhunë.**
- **Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 30.06.2016 deri më datën 29.07.2016.**
- **Të dëmtuarit pas të ndjerit [REDAKTUAR], edhe atë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.**

- Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjeko-ligjore), të paguaj shumën prej 80.88 € /tetë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro /tridhjetë/, në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/euro/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studio materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territorial të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar PP.nr.963-2/16 të dt. 16.11.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 të KPRK-së, si dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurit të shpallet fajtorë dhe të ju shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 28 Maj 2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar: *ndihem fajtor për veprën penale sipas të gjitha pikave të akuzës që ngarkon, shprehi pendimin të thellë për veprën penale të kryer, andaj i kërkoj falje publike familjes së të ndjerit, premtoj gjykatës se në të ardhmen do të shtojë kujdesin në maximum në komunikacionin rrugor, pranimin e fajësisë e bëjë në shenjë pendimi dhe jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojave që mund të vijn nga ky pranim, andaj luti gjykatën të më shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Mbrojtësi i të pandehurit Av. [REDAKTUAR] duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i njëjti deklaron: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim dhe ky pranim është i fajësisë buron pas konsultimeve me mua si avokat. Me që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare i propozoj gjykatës si rrethanë lehtësuese ti merre parasysh këto: është evidente se i akuzuari nuk i ka dëshiruar pasojat e kësaj vepre penale mirëpo megjithatë deri te kjo ka ardhur, ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, ka pasur sjellje shume të mira me palët e dëmtuara, ka vizituar familjen e dëmtuar si dhe ka marrë veprime tjera me qëllim të zbutjes së dhimbjes shpirtërore të familjarëve të viktimës. Andaj, të akuzuarin e kanë goditur aq rëndë pasojat e kësaj vepre penale sqë dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit. Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë si dhe janë pajtuar me familjen e të dëmtuarit tregon rrethanën se edhe me dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Përfaqësuesit, pas të ndjerit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] (djali) dhe [REDAKTUAR] (djali), duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të njëjti njëzëri deklarojnë: ndjekjen penale i le të vendos gjykata në baze të ligjit, ndërsa kërkesën pasurore juridike e kemi paraqitur në procedurë juridiko-civile. Sipas traditave dhe zakoneve jemi pajtuar me familjen e të akuzuarit më tepër nuk kemi se ç'ka të shtojmë.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që gjatë matjes së dënimit ti ketë parasysh si rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës para penale dhe në shqyrtimin gjyqësor si: ekspertiza e inxhinierit të komunikacionit e dt. 18.07.2016, ku në mendimin përfundimtar ka konstatuar se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur për shkak të lëshimeve të automjetit transportues MAN T46, ku ngasësi i automjetit gjatë kycje nga rruga "Enver Topalli" në rrugën "12 Qershori", ka qenë i pakujdesshëm dhe ka bërë kycje të pasigurt sepse gjatë këtij veprimi e godet këmbësorin [REDAKTUAR] në vendkalim të këmbësorëve duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse, andaj shoferi i cili në rrugë synon të bëjë ndonjë veprim me mjetin (lëvizja e mjetit në anën e majtë apo djathtë, të ndal mjetit, të anashkaloj, k'thimin në anën e majtë apo djathtë) i lejohet të filloj vetëm nëse më parë është i bindur se mund të bëjë një gjë të tillë duke mos rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit tjer në komunikacion, po ashtu shoferi i automjetit gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësor duhet të ushtroj kujdes të veçanta dhe ti japë përparësi këmbësorit i cili është ose hynë në vendkalim. Raporti i autopsisë nr. ref. DML MA16-152, dt. 30.06.2016, ku në konkluzionin përfundimtar përcakton se vdekja e të ndjerit është e dhunshme e cila ka ardhur për shkak të fashitjes së qendrave vitale në tru dhe dëmtimeve tjera shumta në organizëm, lëndimet e përshkruara në kuadër të ekzaminimit të jashtëm dhe brendshëm paraqesin thyerje të kockave të kafkës, fytyrës, brinjëve dhe legenit, të unazave të qafës dhe të toraksit, kofshes së majtë rupturë të të gjithë organeve torakale dhe abdominale, të gjitha këtë lëndime kanë mundpr të shkaktohen nga ndonjë mjet i fortë mbretës (psh. siç është automjeti). Raporti i aksidentit nr. 2016-CFT-369 i dt. 30.06.2016, i bërë në vendin e ngjarjes me skicat të paraqitura për pjesëmarrësit në komunikacion, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] dhënë në procedurën parapenale dt. 30.06.2016, si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes si dhe ato të CD-së, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, (nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues

vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, meqë i akuzuari në vend, datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke drejtuar automjetin e markës Man, targa të regjistrimit [REDAKTUAR] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, gjatë kyçjes nga rruga "Enver Topalli" në rrugën "12 Qershori", e godet me pjesën e përparme këmbësorin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K. Ferizaj, i cili ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor, e'i cili nga kjo goditje merr lëndime vdekjeprurëse dhe ndërron jetë në vendin e ngjarjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, kurse si rrethana lehtësuese, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i moshës e re, më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rrethana rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale vlerësoj edhe pasojën e rëndë me fatalitet.

Gjykata është e bindur se edhe me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke u nisur nga fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe dënim ky që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat e kryerjes, si edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjeneralë).

Të dëmtuarit pas të ndjerit [REDAKTUAR], edhe atë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjekoligjore), të paguaj shumën prej 80.88 € /tetë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €uro /tridhjetë/, në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ,

P.nr.2917/17 data. 31.05.2018

Zyrtare ligjore,
Kadisha Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.